



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA ND RYSHE

**EC Ma Ndryshe - Portfolio e aktiviteteve - Projektet në Trashëgimi Kulturore**

**“Hartëzimi i Turizmit Rural në Janjevë”**, ka për qëllim të ndihmoj në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore përmes dokumentimit, promovimit si dhe përmes transferimit të njohurive dhe shkathtësive tek të rinjtë e Janjevës. Në kuadër të projektit synohet që të organizohet “Trajnimi për Zhvillimin e Aftësive për Udhërrëfyesit Turistik (Ciceronëve) në Janjevë”. Grypi kryesor i synuar i trajnimit janë personat e moshës 20 deri 45 vjeç nga të gjitha komunitetet që banojnë në rajonin e Janjevës (Shqiptar, Kroat, Romë, Ashkali, Egjiptas, Turk, Boshnjak). 2022-2023, UNDP .

**“Promovimi i trashëgimisë kulturore përmes fuqizimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe inovative në institucionet muzeale të qytetit të Prizrenit”** ka për qëllim inicimin e hulumtimeve të thelluara mbi identifikimin e nevojave aktuale si dhe dizajnimin e propozimeve inovative të cilat kanë për synim shpërfaqjen e potencialit të shërbimeve që mund të ofrohen nga muzetë aktuale të Prizrenit, me qëllim të ofrimit të modaliteteve për fuqizimin e tyre në raport me gjithëpërfshirjen dhe digjitalizimin. Projekti ofron një sërë aktiviteteve të strukturuar të cilat kanë për synim promovimin e trashëgimisë kulturore të koleksionuar në këto institucione muzeale, me qëllim të pasurimit të jetës kulturore për qytetarët e Prizrenit në përgjithësi, dhe ofertës turistike për turistët në veçanti. 2022-2023, DKRS Prizren.

**“Dollama, aset kulturor i Kosovës”** ka për qëllim të mbajë gjallë/trashëgojë zanatin e qepjes me dorë të veshjeve tradicionale të nusërisë (dollama). Projekti është realizuar në 6 komunat e Rajonit Ekonomik Jugor, rajon ky me potencial për turizëm kulturor. Projekti ka trajnuar 24 gra për qepjen me dorë të dollamave duke kontribuar kështu edhe në punësim të grave. Aktivitetet kryesore të projektit janë: 1. Trajnimi i 24 grave/vajzave për punimin e dollamës; 2. Përkrahja e 4 pjesëmarrëseve më të mira në trajnim me materiale dhe mjete për të ushtruar individualisht këtë zant; 3. Zbatimi i aktiviteteve të ndryshme për të promovuar traditën dhe për të nxitur debatin mbi potencialin dhe mundësitë e shfrytëzimit të turizmit kulturor si mjet për zhvillim ekonomik të këtij rajoni. 2021-2021, UNDP .

**“Hartëzimi i turizmit rural në Kosovën Jugore”** synon të kontribuojë në hartëzimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore përmes dokumentimit, promovimit, transferimit të njohurive dhe aftësive tek të rinjtë dhe komunitetet me prejardhje të ndryshme etnike të Rajonit Ekonomik Jugor (komunat: Prizren, Rahovec, Mamushë, Dragash, Suharekë dhe Malishevë). Projekti synon gjithashtu të rrisë ndërgjegjësimin e institucioneve lokale dhe qendrore mbi konceptin “ende të pazhvilluar dhe paeksploruar plotësisht” të turizmit rural si kontribues në edukim dhe zhvillim të qëndrueshëm të komuniteteve lokale. 2021-2022, UNDP.

**“Tregimtarët e rinj të trashëgimisë së Istogut”** është projekt që ka kontribuar në rritjen e njohurive të qindra nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Istogut për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe potencialit turistik dhe ka ofruar mjete dhe platforma praktike për rritjen e

pjesëmarrjes së të rinjve në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore përmes librit promovues, shoqatës rinore për trashëgiminë dhe aktiviteteve shkollore jashtëshkollore. 2019 – 2020; UNDP .

***“Filigrani përtej artizanatit”*** ka arritur që të transferoj njohuritë dhe aftësoj gratë dhe të rinjtë mbi artizanatin e filigranit përmes programeve arsimore dhe të zhvillimit të kapaciteteve ; ka dokumentuar dhe promovuar artizanatin e filigranit si pasuri të trashëgimisë kulturore jomateriale në prag të zhdukjes; dhe ka zhvilluar një kornizë strategjike të menaxhimit që synon të transformojë Filigranin e Prizrenit në ndërmarrje të qëndrueshme. 2018 - 2019 UNDP .

***“Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren”*** ka prezantuar produkte dhe shërbime të reja informative turistike që mbulojnë gjashtë komuna të Rajonit Ekonomik Jugor ; Ka identifikuar dhe promovuar potencialin turistik kulturor të këtij rajoni bazuar në trashëgiminë kulturore, ngjarjet kulturore, atraksionet natyrore, kuzhinën lokale dhe shërbimet përkatëse ; Ka kontribuar në forcimin e bashkëpunimit të operatorëve turistikë përkatës dhe palëve të interesuara; dhe Ka kontribuar në punësim përmes përfshirjes së bizneseve të vogla në ofrimin e shërbimeve turistike. 2014-2015; UNDP

***“Trashëgimia Kulturore – shtyllë qendrore e zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren”*** ka pasur për qëllim të vlerësoj trashëgiminë kulturore dhe shfrytëzoj potencialin e saj për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të Prizrenit. KCSF